



UNMIK



IPVK

---

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT**

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 36/2006  
PËR RIKULTIVIMIN E TOKËS BUJQËSORE**

**DHJETOR 2006  
PRISHTINË**

---



UNMIK



IPVK

---

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS/ MINISTERIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
VLADA KOSOVA/ MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL  
DEVELOPMENT**

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duke u bazuar në:

Nenin 5.1 paragrafët (n) të Rregullores Nr. 2001/9 të UNMIK-ut të datës 15 maj 2001 të Kornizës Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, nenin 1.3 paragrafi (d) i Rregullores Nr. 2001/19 të UNMIK-ut, të datës 13 shtator 2001 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës dhe nenet 18.6 dhe 44.2 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26, siç është shpallur me Rregulloren Nr. 2006.37 të UNMIK-ut mbi Shpalljen e Ligjit për Tokën Bujqësore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, të dt. 23 Qershor 2006,

Për qëllim të zbatimit të Ligjit për Tokën Bujqësore, duke i specifikuar termet, procedurat dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me ri-kultivimin e tokës bujqësore,

Miraton:

**Udhëzimi Administrativ Nr. 36/ 2006  
Për Ri-kultivimin e Tokës Bujqësore**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të caktoj metodologjinë e hartimit të projekteve për ri kultivim sipas Nenet 18 të Ligjit për Tokën Bujqësore i cili vlen vetëm për projektet për ri kultivim të tokës bujqësore që i nënshtrohet ndërrimit të përkohshëm të destinimit sipas nenit 17 të Ligjit për Tokën Bujqësore.

## **Neni 2**

### **Përmbajtja e projektit të ri-kultivimit**

Projekti për ri kultivim do të përmbaj:

- a) Metodën e heqjes dhe ruajtjes së shtresës së pëlleshme të tokës dhe shtresës me potencial të pëlleshëm;
- b) Procedurat teknike, agro-teknike dhe biologjike të ri kultivimit të tokës bujqësore;
- c) Dinamikën e kthimit të tokës në prodhimtari bujqësore;
- d) Hulumtimin e materieve të dëmshme dhe të rrezikshme në tokën e ri kultivuar; dhe
- e) Shumën financiare të projektit.

## **Neni 3**

### **Heqja dhe Ruajtja e shtresës së pëlleshme të tokës**

Në përshkrimin e projektit për ri kultivim, pjesa që ka të bëjë me metodën e heqjes dhe ruajtjes së shtresës së pëlleshme të tokës dhe shtresës me potencial të pëlleshëm do të përmbaj:

- a) Përshkrimin e tipit të dheut dhe klasës së pëlleshmërisë së dheut;
- b) Përshkrimin e shtresave të dheut që do të ruhet;
- c) Sipërfaqja e dheut natyral të prekur dhe sasinë (vëllimin) e dheut të prekur nga ndërrimi i përkohshëm i destinimit;
- d) Përshkrimin e teknologjisë që do të përdoret për heqjen e dheut;
- e) Përshkrimin e kushteve të ruajtjes së shtresës së pëlleshme të hequr dhe metodat për ruajtjen e kualitetit të dheut;

## **Neni 4**

### **Masat teknike, agro-teknike dhe biologjike të ri kultivimit**

Në përshkrimin e projektit për ri kultivim, pjesa që ka të bëjë me masat teknike, agro-teknike dhe biologjike të ri kultivimit do të përmbaj:

- a) Përshkrimin e masave hulumtuese para fillimit të masave të ri kultivimit për përcaktimin e kontaminimeve të mundshme të dheut dhe ujërave nëntokësore të cilat mund të jenë shkaktuar gjatë periudhës së shfrytëzimit të përkohshëm;

- b) Përshkrimin e materialeve dhe substancave të ruajtura, të shfrytëzuara ose të prodhuara në vendndodhje gjatë periudhës së shfrytëzimit të përkohshëm dhe që mund të jenë përfshirë në dhe, mund të kenë kontaminuar dheun ose ujërat nëntokësore ose mund të jenë lënë në atë vend;
- c) Përshkrimin e procedurave të pastrimit, riparimit dhe teknologjive për mbeturina, kontaminimeve të dheut dhe kontaminimeve të ujërave nëntokësore;
- d) Përshkrimin e metodave që do të zbatohen për rivendosjen e shtresës së pëlleshme të tokës së hequr dhe të ruajtur për kohën e shfrytëzimit të përkohshëm;
- e) Përshkrimin e metodave që do të zbatohen për të përmirësuar veçoritë fizike, kimike dhe biologjike të dheut në nivele që janë së paku të njëjta me kushtet para ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore. Këto mund të përfshijnë masat melioruese dhe përmirësuese të dheut për të zvogëluar dheun e ngjeshur, përmirësoj strukturën e dheut dhe cilësinë e dheut, përmirësoj kapacitetet e shfrytëzimit të ujit, përmirësoj ajrosjen e ujit, përmirësoj vetitë biologjike të dheut dhe përmirësoj pëlleshmërinë e dheut, sipas nevojës;
- f) Masat e aplikuara mund të përfshijnë metodat dhe teknologjitë si atë të lëvrimin, përdorimin e plehrave inorganike dhe organike, përdorimin e përmirësuesve të dheut, masat melioruese të dheut, dhe ndërtimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit;
- g) Përshkrimin e kulturave që planifikohen të mbjellën në tokën e ri kultivuar bujqësore gjatë periudhës pesë vjeçare, që fillon me përfundimin e ri kultivimit.

## **Neni 5**

### **Dinamikat e kthimit të tokës në prodhimtari bujqësore**

Në përshkrimin e projektit për ri kultivim, pjesa që ka të bëjë me dinamikat e kthimit të tokës së ri kultivuar në prodhimtari bujqësore do të përmbajë:

- a) Afatin kohor dhe orarin e aktiviteteve të ri kultivimit;
- b) Përshkrimin e afatit dhe periudhës kohore të zbatimit të masave melioruese të tokës, nëse ato janë pjesë e masave të ri kultivimit;
- c) Përshkrimin e masave pas ri kultivimit për të siguruar ri-kultivim të qëndrueshëm, përfshirë këtu monitorimin dhe masat për përkujdesje të mëtejshme.

## **Neni 6**

### **Hulumtimi i materieve të dëmshme dhe të rrezikshme**

Projekti për ri kultivim, duhet të përmbaj përshkrimin e hulumtimit analitik të dheut dhe ujërave nëntokësore për kontaminues dhe materie të dëmshme e të rrezikshme dhe eliminimin e tyre para kthimit të tokës në prodhimtari bujqësore. Përshkrimi gjithashtu do të përmbaj kriteret e vlerësimit të rrezikut nga kontaminuesit potencial duke u bazuar në legjislacionin e aplikueshëm të mbrojtjes së mjedisit.

**Neni 7**  
**Shuma financiare e projektit**

Përshkrimi i projektit për ri kultivim do të përfshij vlerën e shpenzimit në bazë të vlerësimeve të gjitha aktiviteteve që janë pjesë e projektit për ri kultivim, përfshirë përpilimin, hulumtimin, pastrimin, përmirësimin e dheut, masat melioruese të dheut, si dhe monitorimin dhe masat për përkujdesje të mëtejshme.

**Neni 8**  
**Vlerësimi dhe aprovimi i propozimit të projektit**

8.1. Propozimi i projektit të ri kultivimit do të dërgohet organit komunal kompetent për bujqësi për rishikim, vlerësim dhe aprovim. Në bazë të vlerësimit, organi komunal kompetent për bujqësi mund të kërkoj ndryshime dhe plotësime në projekt para aprovimit.

8.2. Inspeksioni për bujqësi do të përcjell dhe mbikëqyrë zbatimin e projektit të aprovuar të ri kultivimit.

**Neni 9**  
**Gjobat**

Personat që nuk i zbatojnë dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ do t'u nënshtrohet gjobave sipas nenit 42.1 (d) të Ligjit për Tokën Bujqësore.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ do të hyj në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë: 27.12.2006

Zëvendës Ministri i  
Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë  
dhe Zhvillimit Rural  
Tomë Hajdaraj

---